REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
GLLOGOC MUNICIPALITY

| Pranuar | 26.08 | | 2021 |
|---|---|---|---|
| Nj. Org. | Numër | Shtojca | Vlera |
| 13 | 070/01-32489 | | |

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
**Komuna e Drenasit**
Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emërgjencë
**Drenas më dt.26.08.2021**

## Njoftim për plotësim të dokumentacionit për auto -taxi

Bazuar në njoftimin publik me nr. 13.070/03-32489, dt. 15.07.2021, për dhënien e lejeve të operimit operatorëve që do të ushtrojnë veprimtarinë e transportit "auto-taxi" të udhëtareve në territorin e komunës së Drenasit, **njoftohen të gjithë aplikantët** që kanë aplikuar për marrjen e lejes së operimit Auto - Taxi, komisioni i formuar për shqyrtimin e dokumentacionit me numër protokoli 01.020/04-36501, dt. 06.08.2021, bazuar në detyrat e tij ka hartuar raportin e vlerësimit të dokumentacionit për 22 aplikantë.

Sipas raportit të komisionit me numër të protokollit 01.020/04-36501, dt. 24.08.2021, nga gjithsej 22 aplikantë, asnjëri prej tyre nuk i ka plotësuar kriteret (nga 1 – 17) sipas njoftimit publik,

Duke marrë parasysh këtë shpallet afati nga data 27.08.2021 deri 31.08.2021 për plotësimin e dokumentacionit për të gjithë aplikantët të cilëve u mungon dokumentacioni bazuar në plotësimin e kritereve, **dhe të njëjtat i dorëzojnë në zarf të mbyllur në zyrën e arkivit të komunës, dhe të shënohet emri, mbiemri dhe numri i protokollit të mëhershëm, që e keni marr si dëshmi pas aplikimit dhe është pa pagesë dorëzimi.**

Sqarim rreth kritereve të shpalljes për dhënien e lejes se operimit për auto-taxi janë si në vijim:

1. Kriteri 6 (Fuqinë e motorit në Kw), duhet të dëshmohet më dokument( me polisë të sigurimit ose me Certifikatën e kontrollës teknik, ose çfarë do dokumenti të vlefshëm që e dëshmon këtë kriter.
2. Kriteri 7(taksi metri) nuk vlen për aplikantet që konkurrojnë për herë të parë/ Plotësohet para marrjes se lejes se operimit( në mënyrë që të mos shpenzohen aplikantet që nuk kanë punuar më herët në këtë veprimtari,
3. Për kriterin 16, nuk ka nevojë të sillet dokument, sepse e kemi në zyrën tonë, dokumentin që është i lëshuar nga inspektori i komunikacionit,
4. Kriteri 17,(pagesa për parking), nuk vlen për aplikantet që aplikojnë për herë të parë/pagesa bëhet pas plotësimit të dokumentacionit tjetër.

Shtojcë: Lista e aplikanëtve.

Drejtori i DSHPE-së
Lumnije Krapi

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
***Komuna/ Opstina/ Municipality Drenas (Gllogoc)***
***Zyra e Kryetarit***
01 Nr. 020/04-36501 Dt. 24.08.2021

Bazuar në vendimin nr. 01.020/04-36501. datë 06.08.2021. mbi formimin e komisionit për shqyrtimin e dokumentacionit për dhënjen e lejeve operuese për autotaxi. komisioni në përbërje prej:

1. Ibrahim Hajdari – kryetar:
2. Buajr Plakiqi – anëtar:
3. Adhurim Hoxha – anëtar:
4. Ardian Gashi – anëtar:
5. Shpend Bogiqi – anëtar:

Hartojnë raportin me shkrim për vlerësimin e dokumentacionit pë operatorët që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara në bazë të njoftimit publik nga Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë nr. 13.070/03-32489. datës 15.07.2021. për dhënjen e lejeve të operimit që do të ushtrojnë veprimtarinë e transportit "taxi" të udhëtarëve në territorin e komunës së Drenasit.

## Raport

### *Hyrje*

Bazuar në vendimin e lartëcekur në përmbushjen e detyrave të komisionit dhe bazuar në njoftimin publik me numër 13.070/03-32489. të datës 15.07.2021. komisioni filloi punën e tij më datën 13.08.2021 duke shqyrtuar dokumentacionin për auto taxi të gjithësej 22 aplikantëve. Komisioni gjatë punës së tij mbajti shënime dhe procesverbal të vlerësimit të dokumentacionit të aplikantëve. Ditët punuese të komisionit ishin datat: 13.08.2021. 16.08.2021 dhe 18.08.2021.

### *Rezultatet*

Komisioni gjatë shqytimit të dokumentacionit të aplikuesve për "Taxi" harton tabelën e vlerësimit të dokumentacionit për secilin aplikant bazuar në ofrimin e dëshmive për përmbushjen e 17 kritereve si vijon më poshtë ( shiko tabela 1) :

| Të dhënat e aplikesve | | Paraqitja numerike e 17 kritereve dhe vlerësimi me PO ose JO. | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. rendor | Emri & Mbiemri dhe numri i protokolit | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 |
| 1 | Azem Behrami-Apl nr:33592 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 2 | Bexhet Gashi-Apl nr:33829 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 3 | Mujë Istogu-Apl nr:34386 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 4 | Sami Jonuzi-Apl nr:34446 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 5 | Beqir Doshlaku-Apl nr:34664 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 6 | Flamur Hoti-Apl nr:34688 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 7 | Kamer Nebihu-Apl nr:34694 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 8 | Gani Dobordolani nr:34718 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 9 | Arbën Muja-Apl nr:34780 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 10 | Hasan Zariqi-Apl nr:34786 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 11 | Fatmir Hoti-Apl nr:34790 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 12 | Hamdi Leku-Apl nr:34799 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 13 | Daut Xhemajlaj-Apl nr:34822 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 14 | Shemsi Rrustemi-Apl nr:34830 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 15 | Mustaf Morina-Apl nr:34863 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 16 | Hysni Baleci-Apl nr:34866 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 17 | Bashkim Krelani-Apl nr:34870 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 18 | Imer Mulaj-Apl nr:34878 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 19 | Nebi Bërbatovci-Apl nr:34908 | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 20 | Qamil Hoti-Apl nr:35009 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |
| 21 | Skender Sinani-Apl nr:35220 | Po | Jo | Po | Po | Po | Jo | Jo | Po | Po | Jo | Po | Po | Po | Jo | Po | Jo | Jo |
| 22 | Mendin Nura-Apl nr-32971 | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Po | Jo | Jo |

*Tabela 1: Vlerësimi i aplikantëve bazuar në kritere.*

*Përfundim*

Bazuar në të dhënat e vlerësimit të dokumentacionit përfshirë dëshmitë e ofruara të secilit aplikant për taksi. të paraqitura në tabelën më lartë. komisioni vlerëson se nga gjithësej 22 aplikantë. asnjë prej tyre nuk i ka përmbushur të gjitha kriteret për dhënjen e lejes së operimit për veprimtarinë e transportit "TAXI" të udhëtarëve në territorin e komunës së Drenasit.

Vlen të theksohet se kriteri me numër 16 dhe 17 nuk është përmbushur (dëshmuar me dokument) nga asnjë aplikant. Ndërsa për plotësimin e kritereve nga 1 deri në 15 kemi këto rezultate: nga gjithësej njëzet e dy (22) aplikantë vetëm tetë (8) prej tyre kanë arritur të plotësojnë kriteret 1 deri 15. ndërsa katërmbëdhjetë (14) aplikantë të tjerë kanë rezultuar në mos përmbushje të disa prej këtyre kritereve (shiko tabelën më lartë).

**Sqarim:** Këtij raporti i bashkëngjitet lista e kritereve nga 1 deri 17. bazuar në njoftimin publik me numër 13.070/03-32489. të datës 15.07.2021.

Ky raport i'u dërgohet:

- Kryetarit të Komunës:
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Emergjencë:
- Antarëve të komisionit:
- Arkivit:

Komisioni:

1. Ibrahim Hajdari – kryetar ________________
2. Buajr Plakiqi – anëtar ________________
3. Adhurim Hoxha – anëtar ________________
4. Ardian Gashi – anëtar ________________
5. Shpend Bogiqi – anëtar ________________

Vendi: Drenas

Data: 24.08.2021

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOCIT
DREJTORATI PËR SHËRBIME PUBLIKE DHE EMERGJENCË
Nr 070/03-32489 dt. 15.07.2021

Në kuptim të nenit 7 paragrafi 2. nenparagrafi 2.2 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04 L-179 për komunikacion Rrugor. nenit 2 dhe nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit TAX-i të udhëtarëve në Komunën e Gllogocit. nr. 12-344-50040. Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë të Komunës së Gllogocit. shpallë:

## NJOFTIM PUBLIK
## PËR DHËNJEN E LEJEVE TË OPERIMIT OPERATORËVE QË DO TË USHTROJNË VEPRIMTARINË E TRANSPORTIT "TAXI" TË UDHËTARËVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

Njoftohen të gjithë Auto-Tax-it në nivel komunal. që iu skadon afati i Lejeve të Operimit si dhe të atyre Operatorëve që dëshirojnë të merren me këtë veprimtari se me Ligjin 04 L 179 për transportin rrugor në Republikën e Kosovës, janë të obliguar të vazhdojn apo ti marren Lejet e Operimit sipas këtij Ligji.

Nga kjo bazë Drejtorati për Shërbime Publike dhe Emergjencë i Komunës së Gllogocit njofton se këta Operator duhet të paraqesin kërkesën me shkrim pranë këtij Drejtorati që të paisen me leje së operimit me kriteret si në vijim:

1. Kërkesën për Aplikim
2. Çertifikatën e Biznesit e cila duhet të jetë valide dhe nr. Fiskal – fotokopje
3. Vërtetimin e lëshuar nga Drejtorati për Zhvillim Ekonomik se Operatorit ekonomik nu ka borxhe nga viti 2016-2020
4. Vetura të ketë më së shumti (4+1) ulse duke llogaritur edhe ulësen e drejtuesti të automjetit
5. Të ketë së paku 4 dyer
6. Të ketë motorin katër taktësh. me fuqi së paku 36.8 Kë
7. Të ketë taksimetrin në gjendje të rregullt teknike
8. Patentë shoferi – (fotokopje) – kategoria "B" së paku 5 (pesë) vite përvojë si drejtues automjeti
9. Libreza e veturës në emër të pronarit i cili ushtron këtë veprimtari
10. Kontroll teknike (kartoni i vogël më i ri se 6 muaj)
11. Letërnjoftimi (fotokopje)
12. Certifiakta nga Gjykata komunale (që nuk është i dënuar/hetime) – origjinali
13. Certifikata e vendbanimit (fotokopje)( që dëshmon që jeni banor i komunës se Drenasit)
14. Vërtetim që nuk është në marrëdhenie pune – origjinali
15. Certifikata e mjekut me afat validitetit
16. Pëlqimi nga Drejtoria e Inspekcionit (inspektorit të komunikaiconit rrugor).
17. Pgesën që është kryer obligimi për taksen e parkingut.

**Sqarim:** Shenja "TAXI" dhe Shenja "RADIO TAXI" (me madhësi 500x120x80 milimetra, me ngjyrë të verdhë me shkronja të zeza) dhe për kompanitë numrin e evidencës së automjetit TAXI dhe ngjyra duhet të jetë e njejtë.

Aplikacioni merret në zyrën pritëse të komunës se Drenasit (kati përdhesë)

Leja lëshohet në vlefshmëri së paku 5 (pesë) vite.

Afati i aplikimit fillon më dt:15.07. 2021 deri më:30.07. 2021

Kërkesat me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në zyrën e pranimit për çdo ditë pune duke filluar në ora 8:00 – 16:00. ndërsa dokumentacioni i pa kompletuar nuk do të shqyrtohet.

DREJTORI I DREJTORISË
Azemin Kryeziu